




Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për :	Ragip Begaj , Kryetar i Komunës së Malishevës Rrahim Morina , Kryesues i Kuvendit të Komunës së Malishevës	
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Adrijana Hodžić , Ministre e Administrimit të Pushtetit Lokal Rozafa Ukimeraj , Sekretare e Përgjithshme në MAPL	
Nga:	Besim Myrtezani , U.D i Udhëheqësit të Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL	Datë: 09/09/2019 Nr. 020-929
Zyrtarët përgjegjës		
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Ardita Latifi, Zyrtare e lartë për monitorim të komunave	
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të komunës së Malishevës	
Lloji i aktit:	☐ Vendim i Kuvendit të Komunës	

I/e nderuar Kryetar,
I/e nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr. 02/496, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së në Malishevë
I miratuar më datë: 30.08.2019
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 02.09.2019

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.**

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim.
1.	Vendimi Nr. 02/496, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së në Malishevë	Ky vendim nuk prodhon efekte juridike, për arsye se, kuvendi i komunës nuk mund të caktoj lokacion për ndërtimin e objektit të shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së, në pronën e e cila nuk është në pronësi të komunës. Në bazë të certifikatës së pronësisë, njësia kadastrale me numër P-72310047-00501-34, me sipërfaqe 2263 m², në vendin e quajtur Stapanica-Lluga, me kulturë Bujqësore arë e klasës 4, evidentohet pronë e OBM-Mirusha ZK-Malishevë, e cila në bazë të Ligjit Nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, neni 5, është ndërmarrje dhe aset nën autoritetin administrativ të Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Bazuar në këtë, komuna nuk mund ta jep në shfrytëzim apo të caktojë lokacione për ndërtimin e objekteve në pronën e paluajtshme e cila nuk është në pronësi të komunës.

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal kërkon nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimi të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejme në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za:	Ragip Begaj , gradonačelnik opštine Mališevo Rrahim Morina , predsedavajući Skupštine opštine Mališevo	
Cc:	Jedinica za upravljanje dokumentima u MALS Jedinica za upravljanje dokumentima u opštini	
Preko:	Adrijana Hodžić , ministarka administracije lokalne samouprave Rozafa Ukimeraj , generalna sekretarka MALS-a	
Od:	Besim Myrtezani , v.d rukovodioca Pravnog odeljenja i nadgledanje opština, MALS	Dana: 09/09/2019 Br. 020-929
Odgovorni službenici:		
3. Potvrđeno od:	Xhevat Tafa, rukovodilac Odseka za nadgledanje opština	
4. Izrađeno od:	Ardita Latifi, viša službenica za nadgledanje opština	
Predmet:	Zahtev za ponovno razmatranje zakonitosti akta Opštine Mališevo	
Vrsta akta:	☐ Odluka Skupštine opštine	

Poštovani gradonačelnice,
Poštovani predsedavajući,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosova br.01/2016 za administrativno razmatranje opštinskih akata, i na osnovu zakonskih nadležnosti ministarstva, određenim osnovnim zakonima i Vladinom Uredbom br.02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta premijera i ministarstva, odeljenju za pravna pitanja i monitorisanje opština Ministarstva administracije lokalne samouprave je dostavljen sledeći opštinski akt za obavezno razmatranje zakonitosti, onako kako se predviđa članom 81 Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi:

Odluka br.02/496, za određivanje lokacije za izgradnju objekta ratnih udruženja OVK u Mališevu
Usvojena dana: 30.08.2019. godine.
Dotsavljena MALS-u za razmatranje dana: 02.09.2019. godine.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog opštinskog akta, ceni da je opštinski akt **u suprotnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi.**

U nastavku možete naći neslaganja opštinskog akta koji je dostavljen za razmatranje zakonitosti:

		akt u suprotnosti.
1.	Odluka br.02/496, za određivanje lokacije za izgradnju objekta ratnih udruženja OVK u Mališevu	Ova odluka nema pravne efekte jer skupština opštine ne može da odredi lokaciju za izgradnju imovine ratnog udruženja OVK na imovini koja nije u vlasništvu opštine. Prema potvrdi o vlasništvu, katastarska jedinica broj P-72310047-00501-34, sa površinom od 2263m², na mestu zvanom Stapanica-Lluga, zemljište klase 4 namenjeno za poljoprivredu, identifikovano je vlasništvo OBM-Miruša KZ-Mališevo, koji, u skladu sa članom 5 Zakona br.04/L-034 o Kosovskoj agenciji za privatizaciju, je preduzeće i imovina pod administrativnom vlašću Kosovske agencije za privatizaciju. Na osnovu tog, opština ne može izdati na korišćenje ili da odredi lokacije za izgradnju objekata na nepokretnoj imovini koja nije u vlasništvu opštine.

Na osnovu gore navedenog, Ministarstvo administracije lokalne samouprave *traži* od Skupštine opštine/gradonačelnika opštine da preduzmu konkretne mere kako bi se opštinski akt uskladio sa zakonskim odredbama na snazi, u roku od 30 dana od dana dostavljanja zahteva za ponovno razmatranje akta.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštine za bilo kakvo objašnjenje u vezi sa ovom procenom.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës

Nr. 02/496

Datë: 02.09.2019

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministry of Local Government Administration
Data: 02.09.2019
Llogaritja e shprehjes: 020-929

Në bazë të nenit 5 pika b, nenit 8, nenit 12 paragrafi 2 pika d, nenit 14 paragrafi 1, nenit 16, nenit 17 paragrafi 1, nenit 40 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28/15 qershor 2008"), dispozitave të Ligjit nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr.30/23 Gusht 2013"), nenit 10 paragrafi 1 pika h, nenit 19 paragrafi 1 pika a, nenit 46 paragrafi 1, të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871 të datës: 12.11.2008, kërkesën e Kryetarit të Komunës nr.01/1152 datë:30.08.2019, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e -IX- (nëntë) të mbajtur me datë: 30.08.2019 merr këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT
TË SHOQATAVE TË DALA NGA LUFTA E UÇK-së NË MALISHEVË

1. Miratohet vendimi sipas kërkesës nr.01/1152 datë:30.08.2019 të parashtruar nga Kryetari i Komunës së Malishevës, sipas kërkesës nr.01/151 datë: 11.02.2019 të parashtruar nga Komiteti për Familje të Dëshmorëve, Invalid, Veteran të Luftës së UÇK-së, si dhe Martirëve të Luftës në Komunën e Malishevës, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së.
2. Sipas pikës 1 të këtij vendimi lokacioni për ndërtimin e objektit të Shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së në qytetin e Malishevës caktohet në sipërfaqe prej 500m², në pjesën e ngastrës kadastrale nr.P-72310047-00501-34 nga sipërfaqja e përgjithshme prej 2263m², në vendin e quajtur Stapanica-Lluga, me kulturë bujqësore arë e klasës 4, ZK-Malishevë pronë e OPB Mirusha.
3. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Shërbim Pronësoro-Juridik që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të zbatoj të gjitha procedurat e nevojshme ligjore për përcaktimin e pikave përkufizuese në terren të lokacionit të caktuar për ndërtimin e objektit të Shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së.
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, përmes Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Shërbim Pronësoro-Juridik dhe Drejtorisë për Urbanizëm.
5. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 17 të Rregullores nr.01/2017, për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunës, dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet
MAPL-së
Drejtorive të KK-së
Arkivit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit
Brahim Morina

[Signature]



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



PECANJE NË:

REKORDI NË:

PRILJEJO:

NË NDI:

30-08-2019

01-1452

Kryetari i Komunës

Nr. 01/

Datë: 28.08.2019

Nga: Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj.

Për: Kuvendin e Komunës së Malishevës.
Kryesuesit z. Rrahim Morina.

Datë: 28.08.2019.

Kopje: Arkivit të Komunës.

Lënda: Kërkesë për shqyrtimin dhe procedimin e mëtejme të kërkesës nr.01/151, dt.11.02.2019, të parashtruar nga Komiteti për Familje të Dëshmorëve, Invalidëve të luftës së UÇK-së, si dhe Martirëve të Luftës.

Të nderuar anëtarë të Kuvendit të komunës së Malishevës,

Duke vepruar në pajtim me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale Ligji nr.03/L-040, gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28, datë 04 Qershor 2008, neni 4, 8,16,17 par.17.1 dhe Statutit të Kuvendit të Komunës së Malishevës, duke vepruar sipas kërkesës së Komiteti për Familje të Dëshmorëve, Invalidëve të luftës së UÇK-së, si dhe Martirëve të Luftës, nr.01/151,dt.11.02.2019, parashtrojë për shqyrtim dhe procedim të mëtejme këtë kërkesë, në lidhje me ndarje e sipërfaqes së përgjithshme prej 500 m² për ndërtimin e objektit të Shoqatave të dalura nga lufta e UÇK-së-dega në Malishevë.

Lokacioni i kërkuar për realizimin qëllimit të lartcekur është pjesë e ngastrës kadastrale nr.P-72310047-00501-34, në vendin e quajtur Stapanica Lluga, me kulturë bujqësore Arë e klasit 4, ZK-Malishevë, në sipërfaqe të përgjithshme prej 2263 m².

Shpresojë se kërkesa e parashtruar, do të shqyrtohet dhe miratohet pozitivisht!

Ju faleminderit për mirëkuptimin tuaj!

Me respekt,

KUVENDI KOMUNAL MALISHEVË

11-02-2019
01/151.

PËR : KRYETARIN E KOMUNËS Z.RAGIP BEGAJ

NGA: KRYESUESJA E KOMITETIT TË FAMILJEVE TË DËSHMORËVE
,INVALID,VETERAN TË LUFTËS SË UÇK-së SI DHE MARTIRËVE TË
LUFTËS ZNJ.VLORË MANAJ - KRASNIQI

LËNDA : KËRKESË

I nderuari Kryetar i Komunës z.Ragip Begaj ,përmes kësaj kërkesë ju informojmë se ne si komitetet kemi bërë një kërkesë pran zyrës së juaj , për ndarjen e një lokacioni prej 5 ari nga njësia kadastrale P-72310047-00501-34 që gjendet afër xhamisë së qytetit,për ndërtimin e objektit të Shoqatave të dalura nga lufta e UÇK-së dhe deri më sot nuk kemi marrë kurrfarë përgjegjëje.

Kërkesës ja bashkangjesim kërkesën nr.01/334 , datë :10.09.2018 të parashtruar nga Komiteti për Familje të Dëshmorëve , Invalid , Veteran të Luftës së UÇK-së si dhe Martirë të Luftës.Andaj ne si komitet kërkojmë përgjegjëje me shkrim nga ju si kryetar i komunës.

Me respekt



Republika e Kosovës

Komuna e Malishevës



Komiteti për Familje të Dëshmorëve, Invalidë, Veteranë të Luftës së UÇK-së si dhe Martirë të Luftës

PËR: Kuvendin Komunal – Malishevë;

Komitetin për Politikë dhe Financa;

NGA: Komiteti për Familje të Dëshmorëve, Invalidë, Veteranë të Luftës së UÇK-së si dhe Martirë të Luftës

DATA: 30/ 08/ 2018.

LËNDA:

KËRKESË (2)

Të Ndahet një Parcelë për Ndërtimin e një Objekti për Shoqatat e dala nga Lufta e UÇK-së

Komiteti për Familje të Dëshmorëve, Invalidë, Veteranë të Luftës së UÇK-së si dhe Martirë të Luftës (shkurtimisht: Komiteti për FDIVLUÇKML) në mbledhjen e dytë të saj (28. 08. 2018), u dakordua që të bëjë këtë kërkesë drejtuar Kuvendit Komunal dhe Komiteti për Politikë dhe Financa, nga i cili kërkon të ndajë një parcelë prej pesë (5) ari, ku aty do të ndërtohej Objekti e Shoqatave të Luftës së UÇK-së.

Kërkesa jonë është që parcela prej pesë (5) ari për Objektin e Shoqatave të ndahet nga njësia kadastrale P-72310047-00501-34 (që gjendet afër xhamisë së qytetit)


është e detyrueshme që shoq. e veteranëve të UÇK-së të kenë një zyrë
Deri më sot këto Shoqata nuk kanë një zyrë të tyre, e cila do të plotësonte nevojat e shumta për ushtrimin sa më efikas të veprimtarisë së këtyre Shoqatave. Ndërtimi i një objekti të tillë do të sillte një veprimtari më efektive të Shoqatave, të cilat janë mburojë e vlerave të Luftës së UÇK-së. Objekti i ri do të ketë edhe një arkiv të vetin, ku aty do të ruheshin dokumentet e vleshme të historisë sonë më të re.

Kjo kërkesë mbështetet në shqetësimin e të tri Shoqatave: Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së, Shoqata e Invalidëve të Luftëtarëve të UÇK-së dhe Shoqata e Veteranëve të UÇK-së.

Duke besuar se Kuvendi Komunal i Malishevës Komiteti për Politikë dhe Financa do të shqyrtojë me seriozitet kërkesën tonë, presim që nga viti i ardhshëm Shoqatat të posedojnë truallin e tyre, ku aty më pastaj të ndërtohet Objekti i Shoqatave të Vlerave të Luftës së UÇK-së.

Kërkesën në fjalë e mbështesin të gjithë drejtuesit e këtyre Shoqatave, duke jap autografin e tyre në fund të kësaj kërkesë.

Ky domument është nënshkruar nga:

1. Vlorë MANAJ - KRASNIQI, kryetare e Komitetit për FDIVL UÇKML 
2. Sinan GEGAJ, kryetar i Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve 
3. Fatmir BUQAJ, kryetar i Invalidëve të UÇK-së 
4. Metush KRYEZIU, kryetar i Veteranëve të UÇK-së 

Malishevë:

30. 08. 2018.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR / MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA / MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTRARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTRARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-72310047-00501-34

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	1224-2019
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	27.08.2019 - 11:54
Komuna / Opština / Municipality:	Malishevë / Mališevo / Malishevë
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	MALISHEVË / MALIŠEVO / MALISHEVË
Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	Malishevë / Mališevo / Malishevë

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACIO KATASTRARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i proarës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-72310047-00501-34	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Prone shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Urban	2263	Aktvendim Nr 06-155-2018 dt 15.02.2018	15.02.2018	

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTRARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendbanimi - adresa Prebivaliste - adresa Resident - address	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësi të adresës Pojednostoi adrese Address Details	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
STAPANICA-LLUGA/STAPANICA-LLUGA		STAPANICA-LLUGA	15.02.2018	

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numbri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parces Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parces Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klases kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja Površina Area
1	Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture	Aval/Njive/Arable	Arë E Klases 4/Njiva 4 Klase/4th Class Arable Land	2263

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojedinosli adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posehim individual / Individualna Drzavina / single possessor	OPB MIRUSHA	KCID2300295	MALISHEVË / MALIŠEVO / MALIŠEVE /			1/1	Kontratë Ev.nr.269/72 dt 22.09.1972	15.02.2018



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosova

Qeveria -Vlada-Government


Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministartstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : MALISHEVE

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Malisheve

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m2
P-72310047-00501-34	Parcelë / Parcela / Parcel	2263,0



Shkalla/Razmera/Scale: 1:585

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 02.09.2019

Koha/ Vreme/ Time: 10:55:46

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:

Shënim/Beleška/Note:

Provai/Usvojio/Approved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Siganture: